



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
URDHRI I PSIKOLOGUT  
KËSHILLI KOMBËTAR



Tiranë, më 13/02/2025

VENDIM

Nr.3, datë 13.02.2025

Në mbështetje të ligjit 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, bazuar në nenin 10, gërma b), neni 16 pika 2, gërma d), të këtij ligji, si dhe Regulloren e Edukimit në Vazhdim në Psikologji, Këshilli Kombëtar

VENDOSI:

1. Të miratojë me unanimitet, lehtësimin e procedurave të rilicencimit të psikologëve, të cilët kanë përfunduar afatin e licencës përpara periudhës së përfundimit të efekteve të Vendimit Nr.4 datë 09.04.2024 për pezullimin e aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim, si më poshtë:
  - a. Psikologët të cilët kanë mbledhur në mënyrë kumulative deri 50 kredite (kategoria e të licencuarve (2017-2018) ose 70 kredite (kategoria pas vitit 2018) dhe kanë nevojë edhe për 30 kredite për të mbyllur procedurat, të **rilicencohen menjëherë pa asnjë detyrim shtesë.**
  - b. Psikologët e të dyja kategorive (të licencuar para dhe pas 2018) që nuk kanë mbushur numrin minimal të krediteve, përkatësisht 50 ose 70 kredite, t’i nënshtrohen menjëherë **testimit të rilicencimit** të organizuar nga Urdhri i Psikologut sipas rregulloreve në fuqi.
  - c. Psikologët e përfshirë në pikën 2 të këtij propozimi të kryejnë pagesën bazë **prej 15.000 lekë të testimit të miratuar me vendim të Këshillit Kombëtar dhe të përjashtohen nga çdo detyrim financiar.**
  - d. Ky vendim të shtrijë efektin e tij deri në një vendim tjetër të Këshillit Kombëtar që anulon vendimin Nr.4 datë 09.04.2024, për pezullimin e aktiviteteve të Edukimit në Vazhdim .
2. Bashkëngjitur relacioni i Zyrës Juridike.

PRESIDENTE E URDHRI

Dr.Valbona TRESKA

SEKRETARE

Arlinda KËRÇI

Bhv. Gjergj Fishta, Ndërtesa nr. 26, kati II, Ap.9, Tiranë  
email: [sekretaria@urdhriipsikologut.al](mailto:sekretaria@urdhriipsikologut.al), Tel.: 0035542209927